

Raporti i vlerësimit në terren të projekteve të infrastrukturës lokale, Komuna Ksamil

Ujësjiellësi Ksamil (vazhdim)

Qarku	Vlorë
Rrethi	Sarandë
Komuna	Ksamil
Objekti	Ujësjiellësi Ksamil (vazhdim)
Vlera e parashikuar (punime, tvsh)	35,018,893 Lekë
Nr i përfituesve të drejtpërdrejtë	2000
Kosto (Lekë/banorë)	17,509
Gjatësia e Investimit (m)	7,450

Përshkrim i përgjithshëm i projektit dhe foto dixhitale të objektit të propozuar

Projekti parashikon të shtrijë rrjetin e shpërndarjes në lagjen më në jug të Ksamilit. Sistemi ka aftësi të furnizojë me ujë këta banorë dhe ta bëjë këtë rregullisht. Me këtë investim krijohet mundësia e furnizimit me ujë të të gjithë banorëve dhe e operimit dhe menaxhimit më të mirë të sistemit të ujësjiellësit.

Foto



Zona që do të përfitojë nga projekti ujësjiellës



Pika e lidhjes për furnizimin e zonës së pambuluar nga ujësjiellës

Gjendja Ekzistuese: Aktualisht furnizimi me ujë i kësaj pjese bëhet me linja tubacionesh të shtrira pa rregull dhe pa matës sa për të bërë furnizimin emergjent të kësaj zone.

Impakti social-ekonomik: Realizimi përfundimtar i këtij projekti do të përmirësojë në furnizimin me ujë për 24 orë të kësaj zone të papërfshirë më parë në sistemin e përgjithshëm të furnizimit me ujë.

Komente për cilësinë teknike të projektit:

Projekti është i gatshëm për zbatim.

Ky sistem furnizimi me ujë në perspektivë i ka të gjitha mundësitë të furnizohet me GRAVITET nga Ujësjellësi i Sarandës i cili do të marrë ujë nga burimi i Tatzatit (24 km), duke shmangur përdorimin e energjisë elektrike të stacioneve të pompimit.

